

VENDIM QARKULLUES

Nr. 22, datë 14.9.2018

PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS NBG ALBANIA SHA, TË PËRTHITHUR NGA BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6 të Rregullores, “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 1, të rregullores, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 220, pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 6.9.2018, “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., me Bankën NBG Albania sh.a.”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën NBG Albania sh.a., të përthithur nga bashkimi me Bankën Amerikane të Investimeve sh.a.
 2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës NBG Albania sh.a. Ngarkohet Banka NBG Albania sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës NBG Albania sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
 5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës NBG Albania sh.a. si shoqëri e përthithur.

**KRYETAR
Donald Duraj**

